VENDIM
Nr. 863, datë 27.12.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 147, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 3, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Struktura dhe organika e ASIGUT-t miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në fuqi të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore.".

2. Pas pikës 2, të nenit 7, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Drejtori i përgjithshëm i ASIGU-t mbështetet nga një zëvendësdrejtor.".

3. Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i nenit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Funksioni i koordinimit ndërinstitucional, i administrimit dhe përpunimit të informacionit gjeohapësinor";

b) Fjalia hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Në kuadër të koordinimit ndërinstitucional, administrimit dhe përpunimit të informacionit gjeohapësinor, ASIG-u ushtron këto funksione:".

c) Pas shkronjës "j" shtohen shkronjat "k", "l", "ll", "m", "n" dhe "nj", me këtë përmbajtje:

"k) administrimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj., të vëna në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes, apo institucione në varësi të saj, si dhe të krijuara nga ASIG-u, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj;

l) përpunimin dhe analizimin e të dhënave të informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë etj.;

ll) shpërndarjen e informacionit të përpunuar gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë etj., për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë;

m) bashkëpunimin me ministritë apo institucionet për caktimin e personave përgjegjës/pikës së kontaktit, të nevojshëm për analizimin dhe përpunimin e thelluar të informacionit të marrë nga teknologjitë e avancuara;

n) hartimin, në bashkëpunim me ministritë apo institucionet, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të manualeve dhe udhëzimeve të nevojshme për mënyrën e përdorimit të informacionit të përftuar nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar, të cilat miratohen nga drejtori i përgjithshëm, brenda 6 muajve nga aplikimi i kësaj teknologjie;

nj) përpunimin e të dhënave nga sistemet me qëllim prodhimin e raporteve të ndryshme në ndihmë të grupeve të interesit, për qëllime vendimmarrjeje apo statistikore.".

4. Neni 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 16

Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të ASIG-ut rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”.

5. Pas kreut V shtohet kreu VI, me këtë përmbajtje:

“KREU VI
DISPOZITË KALIMTARE

Për nëpunësit aktualë të ASIG-ut zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.”.

II. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama